

LIGJ
Nr .9056, date 24.4.2003

PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE "KONVENTEN
NDERKOMBETARE PER KERKIM-SHPETIMIN NE DET"

Ne mbështetje te neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit te Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon ne "Konventën ndërkombëtare për kërkim-shpëtimin ne det" .

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3812, date 8.5.2003 te Presidentit te Republikës se Shqipërisë, Alfred Moisiu.

KONVENTA NDERKOMBETARE
MBI KERKIM-SHPETIMIN NE DET, 1979

Vendet anëtarë te Konventës:

Duke marre parasysh rëndësinë e madhe qe i është kushtuar ne disa prej Konventave
dhënies se ndihmës ne det ndaj personave qe janë ne fatkeqësi dhe ne lidhje me krijimin nga
çdo shtet bregdetar te organizmave përkatëse dhe efektive për vrojtimin dhe shërbimin e
shpëtimit;

ne mbështetje te rekomandimit nr.40 te adaptuar nga Konferenca Ndërkombëtare mbi
Sigurimin e Jetës se Njeriut ne Det e vitit 1960, ne te cilin shprehet dëshira e koordinimit te
aktiviteteve qe kane te bëjnë me sigurinë ne det nëpërmjet një sere organizmash
ndërqeveritare;

me dëshirën e zhvillimit dhe nxitjes se këtyre aktiviteteve me anën e krijimit te një plani
ndërkombëtar për kërkim-shpëtimin ne det, plan ky qe i përgjigjet nevojave te trafikut detar
për shpëtimin e personave ne fatkeqësi ne det;

duke dëshiruar nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet organizmave te kërkim-shpëtimit ne te
gjithë boten dhe atyre te vendeve pjesëmarrëse ne operacionet e kërkim-shpëtimit ne det;
ranë dakord si me poshtë:

Neni 1

Detyrime te përgjithshme sipas Konventës

Vendet anëtarë për t'i dhënë fuqi te plote zbatimit te Konventës dhe anekseve te saj, te cilat
janë pjese integrale e Konventës janë te detyruara te marrin te gjitha masat ligjore etj.

Ne rast se nuk është shprehur ndryshe, referencat ndaj konventës do të kuptojnë ne te njëjtën kohe edhe referencat ndaj anekseve të saj.

Neni 2 Traktatet e tjera dhe interpretimi

1. Në këtë Konventë asgjë nuk paragjykon kodifikimin dhe zhvillimin e ligjit të detit të Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit të mbajtur në zbatim të rezolutës 2750 (XXV) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, si dhe anekseve aktuale dhe të ardhshme ose ndonjë çështje detare ligjore të ndonjë shteti në lidhje me ligjin e detit dhe natyrën e juridiksionit të shtetit bregdetar.
2. Asnjë parashikim i Konventës nuk duhet të ndërtohet në formë të tilla që të paragjykojë detyrimet dhe të drejtat e anijeve, të cilat janë parashikuar në konventat e tjera ndërkombëtare.

Neni 3 Amendamentet

1. Konventës mund t'i bëhen amendamente sipas njëres prej procedurave të specifikuar në paragrafët 2 dhe 3 të shprehura më poshtë.
2. Amendim mbas shqyrtimit brenda organizatës ndërkombëtare detare (që këtu e më poshtë do të referohet si "Organizata").
 - a) Çdo amendament i propozuar nga një vend dhe që i është transmetuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës (që këtu e më poshtë do të quhet Sekretari i Përgjithshëm) ose çdo amendament i menduar si i domosdoshëm nga Sekretari i Përgjithshëm, si rezultat i një amendamenti të një parashikimi që i përket Aneksit nr. 12 të Konventës mbi Aviacionin Ndërkombëtar Civil, do të qarkullohet në të gjithë anëtarët e Organizatës dhe të gjithë vendet të paktën 6 muaj para shqyrtimit të tij nga Komitetit i Sigurisë Detare të Organizatës.
 - b) Vendet anëtarë ose jo të organizatës kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e Komitetit të Sigurisë Detare për shqyrtimin dhe adaptimin e amendamenteve.
 - c) Amendamentet do të adaptohen në rastin kur votojnë 2/3 e vendeve anëtarë të Komitetit të Sigurisë Detare, që kanë të drejtë votimi, me kusht që të paktën 1/3 e vendeve anëtarë, të marrin pjesë në momentin e adaptimit.
 - d) Amendamentet e adaptuara në përputhje me nënparagrafët (a), (b), (c) i komunikohen nga Sekretari i Përgjithshëm të gjitha vendeve anëtarë për pranim në parim.
 - e) Amendamenti që behet ndaj një neni apo paragrafëve 2.1.4, 2.1.5, 2.1.7, 2.1.10, 3.1.2 ose 3.1.3 të aneksit merren si të pranuar në datën në të cilën Sekretari i Përgjithshëm ka marrë instrumentin e pranimin nga 2/3 e vendeve anëtarë;
 - f) Amendamenti që behet ndaj një aneksi, përveç paragrafëve 2.1.4, 2.1.5, 2.1.7, 2.1.10, 3.1.2 ose 3.1.3 të aneksit do të presupozohen të jenë pranuar në fund të një viti, nga data në të cilin ai i është komunikuar vendeve anëtarë për pranim. Megjithatë ai presupozohet se nuk është pranuar, nëse brenda kësaj periudhe kohore me shumë se 1/3 e vendeve anëtarë, njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm se atë janë kundër amendamentit.
 - g) Amendamentet ndaj neneve 2.1.5, 2.1.7, 2.1.10, 3.1.2 ose 3.1.3 të aneksit hyjnë në fuqi:
 - i. për ato vende që kanë pranuar atë, gjashtë muaj pas datës në të cilën ai presupozohet të jetë pranuar;
 - ii. për atë vende që e kanë pranuar atë sipas kushteve të përshkruara në nënparagrafin (e) dhe kur këto kushte janë plotësuar, para se amendamenti të hyjë në fuqi, në datën e hyrjes në fuqi të amendamentit.

iii. për atë vende që e kanë pranuar atë pas datës së hyrjes në fuqi të amendamentit, 30 ditë mbas depozitimit të instrumentit të pranimit.

Amendamenti që behet ndaj një aneksi përveç paragrafëve 2.14, 2.1.5, 2.1.7, 2.1.10, 3.1.2 ose 3.1.3 hyn në fuqi për të gjitha vendet, përveç atyre vendeve, të cilët e kanë kundërshtuar amendamentin sipas paragrafit f dhe që nuk kanë tërhequr këtë kundërshtim 6 muaj pas datës, në të cilën ai presupozohet të pranuar. Megjithatë para datës së përcaktuar të hyrjes në fuqi çdo vend mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm që ai përjashton vetveten nga zbatimi i këtij amendamenti për një periudhë jo më të gjatë se një vit nga data e hyrjes në fuqi të tij ose për një periudhë të tillë të gjatë siç përcaktohet nga 2/3 e vendeve që janë prezent në votim në Komitetin e Sigurisë Detare në kohën e adaptimit të amendamentit.

Amendamenti i bërë nga një konference:

Në bazë të kërkesës së një vendi anëtar e mbështetur kjo nga të paktën 1/3 e vendeve anëtarë.

Organizata është e detyruar të mbledhë një konference të vendeve anëtare për të shqyrtuar amendamentet e Konventës. Amendamentet e propozuara qarkullohen nga Sekretari i Përgjithshëm tek të gjitha vendet anëtarë të paktën 6 muaj para shqyrtimit nga Konferenca. Amendamentet adaptohen nga një konference prej 2/3 e vendeve anëtarë që janë prezent në votim, me kusht që të paktën 1/3 e të gjithë vendeve anëtarë të jete prezent në momentin e adaptimit të amendamentit. Amendamentet e miratuara në këtë mënyrë i komunikohen të gjitha vendeve anëtarë për pranim nga Sekretari i Përgjithshëm.

Në rast se Konferenca nuk vendos ndryshe, amendamenti konsiderohet të pranuar dhe hyn në fuqi, në përputhje me procedurat e përcaktuara respektivisht në paragrafët 2. (e), 2.(f), 2. (g) dhe 2.(h), me kusht që referenca në nënparagrafin 2.(h) e Komitetit të Sigurisë Detare shtrihet në përputhje me nënparagrafin 2.(b) dhe merret si mjet reference për Konferencën.

Çdo deklaratë për pranim ose kundërshtim të një amendamenti ose ndonjë njoftimi i dhënë sipas paragrafit 2.(h) dorëzohet me shkrim tek Sekretari i Përgjithshëm, i cili informon të gjitha vendet anëtarë për një njoftim të tillë, si dhe për datën e marrjes së njoftimit.

Sekretari i Përgjithshëm njofton shtetet për amendamentet që hyjnë në fuqi, së bashku me datën në të cilën këto amendamente hyjnë në fuqi.

Neni 4

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, aprovimi, njohja

1. Konventa mbetet hapur për nënshkrim, në zyrat e organizatës nga data 1 nëntor 1979 deri më 31 tetor 1980 dhe me vonë do të mbetet e hapur për anëtarësim.

Shtetet mund të bëhen anëtarë të Konventës me anën e një nga procedurat e mëposhtme:

- a) nënshkrimit pa rezerva për ratifikim, pranim ose miratim;
- b) nënshkrimit si subjekt i ratifikimit, i pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi;
- c) pranimi.

2. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose anëtarësimi duhet të zbatohen me anën e depozitimit të instrumentit përkatës për këtë qëllim tek Sekretari i Përgjithshëm

3. Sekretari i Përgjithshëm informon shtetet për çdo nënshkrim ose depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi ose anëtarësimi si dhe për datën e depozitimit.

Neni 5

Hyrja në fuqi

1. Konventa hyn në fuqi 12 muaj pas datës së bërjes anëtarë të 15 shteteve në përputhje me procedurat e përmendura në neni IV.

2. Hyrja ne fuqi për shtetet te cilët e ratifikojnë, pranojnë, miratojnë ose bëhen anëtarë te Konventës do te behet 30 dite pas datës se depozitimit te instrumentit ne përputhje me nenin IV mbas datës se hyrjes se Konventës ne fuqi.
3. Hyrja ne fuqi, për shtetet qe e ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë ose bëhen anëtarë ne Konvente ne përputhje me procedurat ne nenin 4 dhe qe kane plotësuar kushtet e përmendura ne paragrafin 1 para hyrjes ne fuqi te Konventës behet ne ditën e hyrjes ne fuqi te Konventës.
4. Çdo instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose anëtarësimi i depozituar pas datës se hyrjes ne fuqi te Konventës ne përputhje me nenin 3 zbatohet ndaj Konventës se bashku me amendamentet ne momentin e depozitimit dhe hyn ne fuqi për një shtet qe ka depozituar instrumentin, 30 dite pas datës se depozitimit te tij.
5. Sekretari i Përgjithshëm informon për datën e hyrjes ne fuqi te Konventës.

Neni 6 Denoncimi

1. Konventa denoncohet nga çdo vend anëtar ne çdo kohe pas kalimit te 5 vjetëve nga data e hyrjes ne fuqi te Konventës ne atë vend.
2. Denoncimi behet me anën e depozitimit te një instrumenti depozitimi tek Sekretari Përgjithshëm, i cili njofton shtetet për instrumentin e denoncimit qe është paraqitur, si dhe datën e marrjes se tyre dhe datën e fillimit te zbatimit te denoncimit.
3. Denoncimi zbatohet për një vit ose për një periudhe te tille siç mund te jete specifikuar ne instrumentin e denoncimit te marre nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 7 Depozitimi dhe regjistrimi

1. Konventa depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm, i cili u transmeton kopjet e vërtetuara te gjitha shteteve anëtarë.
2. Ne momentin e hyrjes ne fuqi, Sekretari i Përgjithshëm i transmeton Sekretarit te Përgjithshëm te Kombeve te Bashkuara tekstin e konventës për regjistrim dhe publikim ne përputhje me nenin 102 te Konventës se Kombeve te Bashkuara.

Neni 8 Gjuhet

Konventa është përgatitur ne një kopje te vetme ne gjuhen kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle. Çdo tekst është autentikisht i barabarte. Përkthimet zyrtare ne gjuhet arabe, gjermane dhe italiane do te përgatiten dhe depozitohen me nënshkrimin origjinal. Bere ne Hamburg ditën e 27 te prillit te vitit 1979. Ne dëshmi te se cilës, duke qene te autorizuar nga qeveritë respektive për këtë qellim, kane firmosur Konventën.

ANEKS

KAPITULLI 1 TERMAT DHE PERKUFIZIMET

- 1.1 Termi "shall" përdoret ne aneks për te treguar qe një parashikim, duhet te zbatohet ne mënyrë uniforme nga te gjitha shtetet ne interes te sigurisë se jetës ne det.
- 1.2 Termi "should" përdoret ne aneks për te treguar qe një parashikim, rekomandohet te aplikohet ne mënyrë uniforme nga te gjithë shtetet ne interes te sigurisë se jetës ne det.
- 1.3. Termat e përmendura këtu me poshtë kane kuptimin qe vijojnë:
- 1.3.1. "Rajoni i kërkim-shpëtimit" nënkuptojmë një zone me dimensione te përcaktuara brenda se cilës sigurohen shërbimet e kërkim-shpëtimit.
- 1.3.2. "Qendra te koordinimit te shpëtimit" nënkuptojmë njësinë qe ka përgjegjësi për organizimin efikas te kërkim-shpëtimit dhe koordinimin e kryerjes se operacioneve te kërkim-shpëtimit brenda rajonit te kërkim shpëtimit qe i përket asaj.
- 1.3.3. "Nënqender shpëtimit" nënkuptojmë, njësinë qe varet nga një qendër e koordinimit te kërkim-shpëtimit e krijuar për te ndihmuar këtë te fundit brenda një zone te përcaktuar te kërkim-shpëtimit.
- 1.3.4. "Njësi e vrojtimit bregdetar" nënkupton një njësi tokësore stacionare ose lëvizëse (njësi vrojtuese bregdetare) e specializuar për te kryer vrojtim mbi sigurinë e anijeve ne zonat bregdetare.
- 1.3.5. "Njësi shpëtimit" nënkupton një njësi te përbëre nga një personel i stërvitur dhe i pajisur me pajisjet e përshtatshme për kryerjen e shpejte te operacioneve te kërkim-shpëtimit.
- 1.3.6. " Drejtuesi ne komande" nënkupton drejtuesin e një njësie te specializuar për te koordinuar veprimet e kërkim-shpëtimit brenda një zone te specifikuar kërkimi.
- 1.3.7. "Koordinatorja e sipërfaqes se kërkimit" nënkupton një anije te posaçme e veçante nga njësia e specializuar për koordinimin e veprimeve te hapësirave te kërkim-shpëtimit brenda një rajoni kërkim shpëtimit.
- 1.3.8 "Faza e emergjencës" nënkupton një faze pasigurie, alarmi ose fatkeqësie.
- 1.3.9. "Faza e pasigurte" nënkuptojmë një situatë te pasigurte për sigurinë e anijes dhe personave ne bordin e saj.
- 1.3.10 "Faza e alarmit", nënkuptojmë një situatë ku ekziston frika për sigurinë e anijes ose personave ne bordin e saj.
- 1.3.11. "Faza e rrezikut", nënkuptojmë një situatë ne te cilën është e sigurtë se një person ose një anije rrezikohet nga një rrezik i menjëhershëm dhe i rende dhe kërkon ndihme te menjëhershme.
- 1.3.12. "Rrëzim" nënkupton ne rastin e një avionit, një ulje te detyruar ne sipërfaqen e ujit.

KAPITULLI 2 ORGANIZIMI

Masat për parashikim dhe koordinimin e shërbimeve te kërkim-shpëtimit.

2.1.1 Vendet anëtarë duhet te garantojnë se kane marre masat e nevojshme për sigurimin e shërbimeve te posaçme te kërkim-shpëtimit për personat ne fatkeqësi ne det për rreth bregdetit te tyre.

2.1.2. Vendet anëtarë janë te detyruara te parashitrojnë tek Sekretari i Përgjithshëm informacionin mbi organizimin e kërkim-shpëtimit dhe ndryshimet qe kane bere dhe qe janë te rëndësishme për këtë organizim duke përfshirë:

2.1.2.1. Shërbimet nacionale te kërkim-shpëtimit ne det.

2.1.2.2. Vendndodhjen e qendrave te kërkim-shpëtimit, numrin e tyre te telefonit dhe teleksit, si dhe zonat e tyre te përgjegjësisë.

2.1.2.3. Anijet kryesore te shpëtimit ne dispozicion te tyre.

2.1.3. Sekretari i Përgjithshëm i transmeton me rrugën me te përshtatshme te gjitha vendeve anëtarë informacionin e referuar ne paragrafin 2.1.2.

2.1.4. Çdo rajon kërkim-shpëtimit krijohet ne marrëveshje ndërmjet vendeve anëtarë te përfshira ne rajon. Sekretari i Përgjithshëm duhet te njoftohet për marrëveshje te tilla.

2.1.5. Ne rastin e mosarritjes se një marrëveshje me dimensione fikse te rajonit te kërkim-shpëtimit ndërmjet vendeve anëtarë te rajonit, këto vende duhet te bëjnë te gjitha përpjekjet për te arritur marrëveshje mbi bazën e masave te duhura sipas te cilave sigurohet koordinimi i përgjithshëm i kërkim-shpëtimit ne një rajon. Për marrëveshje te tilla njoftohet Sekretari i Përgjithshëm.

2.1.6. Sekretari i Përgjithshëm njofton te gjitha vendet për marrëveshjet ose masat e marra sipas paragrafëve 2.1.4 dhe 2.1.5.

2.1.7. Përcaktimi i rajoneve te kërkim-shpëtimit nuk lidhet dhe nuk paragjykon definicionet dhe përcaktimet ne lidhje me kufirin shtetëror.

2.1.8. Vendet anëtarë duhet te organizojnë shërbimin e tyre te kërkim-shpëtimit ne mënyrë te tille qe t'i përgjigjen menjëherë thirrjes se fatkeqësisë.

2.1.9. Autoritetet përgjegjëse te vendit qe është anëtar dhe qe siguron koordinimin e përgjithshëm te operacioneve te kërkim-shpëtimit me marrjen e informacionit qe një person është ne fatkeqësi ne det, duhet te marrin masa urgjente për te siguruar ndihmën e duhur qe kane ne dispozicion.

2.1.10. Vendet anëtarë duhet te garantojnë sigurimin e ndihmës ndaj do personi ne fatkeqësi ne del. Ato janë te detyruara te veprojnë ne mënyrë te tille pavarësisht nga nacionaliteti ose statusi i personit ose rrethanat ne te cilat ndodhet personi.

Koordinimi i pajisjeve te kërkim shpëtimit

2.2.1. Vendet anëtarë janë te detyruara te marrin masa për koordinimin e pajisjeve te kërkim shpëtimit për te siguruar shërbimin e kërkim shpëtimit gjate bregdetit te tyre.

2.2.2. Vendet anëtarë themelojnë një mekanizëm nacional për koordinimin e përgjithshëm te shërbimeve te kërkim-shpëtimit

Krijimi i qendrave dhe nenqendrave te koordimit te kërkim shpëtimit

2.3.1. Për te plotësuar kërkesat e paragrafëve 2.2.1 dhe 2.2.2 vendet krijojnë qendrat e koordinimit te shpëtimit për shërbimet e tyre, si dhe nen qendrat po te shihet e arsyeshme.

2.3.2. Autoritetet kompetente te çdo vendi përcaktojnë zonat për te cilat janë përgjegjëse për nenqendrat.

2.3.3. Çdo qendër koordinimi për kërkim-shpëtimit, si dhe nenqender e ngritur ne përputhje me paragrafin 2.3.1. duhet te këtë mjete te përshtatshme për kapjen e sinjaleve te fatkeqësisë me anën e një radiostacioni bregdetar ose mjete te tjera. Çdo qendër ose nen qendër e tille duhet te këtë gjithashtu mjete te përshtatshme për te komunikuar me njësitë e saj te shpëtimit, si dhe me qendrat ose nenqendrat e koordinimit te shpëtimit sipas rastit, ne zonën fqinje.

Përcaktimi i njësive te kërkim-shpëtimit

2.4.1. Vendet anëtarë duhet te përcaktojnë:

2.4.1.1. Njësitë e shpëtimit për shërbimet përkatëse qe mund te jene publike, shtetërore ose private, si dhe pjese te tyre, te cilat kane vendndodhje dhe pajisje te përshtatshme;

2.4.1.2. elementet e organizimit për shërbime te kërkim-shpëtimit shtetërore, publike ose private, ose pjese te tyre, jo te përshtatshme për t'u përcaktuar si njësi shpëtimit, por qe janë te afta te marrin pjese ne operacione kërkim-shpëtimit, si dhe përcaktojnë funksionet e këtyre elementeve.

Instalimet dhe pajisjet e njësive te shpëtimit

- 2.5.1. Çdo njësi shpëtimi duhet të pajiset me instalime dhe pajisje të përshtatshme për të kryer detyrën.
- 2.5.2. Çdo njësi shpëtimi duhet të këtë mjete të shpejta dhe të besueshme komunikimi me njësitë ose elementet e tjerë të angazhuara në të njëjtin operacion shpëtimi.
- 2.5.3. Kontejnerët ose pakot të përmbajnë pajisje shpëtimi për t'u hedhur për të shpëtuar, duhet të kenë pamjen e përgjithshme të përmbajtjes së tyre të treguar nga një kod ngjyrash në përputhje me paragrafin 2.5.4., si dhe nga tregimet e simbolet e shkruara në rast se ato ekzistojnë.
- 2.5.4. Ngjyra e identifikimit të përmbajtjes së kontejnerëve që hidhen dhe pakove që përmbajnë pajisje shpëtimi duhet të këtë formën e valëzuar në përputhje me kodin që vijon:
- 2.5.4.1. e kuqe- Furnizime mjekësore dhe pajisje të dhënies së ndihmës së parë;
- 2.5.4.2. blu - ushqim dhe ujë
- 2.5.4.3. e verdhe - batanije private, si dhe pjesë të tyre të cilat kanë vendndodhje dhe pajisje të përshtatshme;
- 2.5.4.4 e Zeze- Pajisje të ndryshme si soba, sëpata, busulla dhe mjete ngrënie e gatimi.
- 2.5.5. Aty ku pajisjet e përmbajtjes janë të përziera në një pako ose konteiner, kodi i ngjyrave duhet të jete i kombinuar.
- 2.5.6. Instruksionet mbi përdorimin e pajisjeve të shpëtimit duhet të jene të futura në çdo konteiner ose pako që hidhet në det. Ato duhet të jene të shkruara në anglisht dhe gjithashtu të paktën në 2 gjuhë të tjera.

KAPITULLI 3 BASHKEPUNIMI

Bashkëpunimi ndërmjet shteteve

- 3.1.1. Vendet duhet të koordinojnë organizmat e tyre të kërkim-shpëtimit dhe kur është e nevojshme dhe operacionet e kërkim-shpëtimit me shtetet fqinje.
- 3.1.2. Po të mos jete rënë dakord ndryshe ndërmjet vendeve të interesuara, secili nga ato duhet të autorizojë mbi bazën e legjislacionit kombëtar, rregullave dhe udhëzimeve, në ujërat territoriale, hapësirën detare dhe rajonet e kërkim-shpëtimit, hyrjen e menjëhershme të njërive të kërkim-shpëtimit të vendeve të tjera me qëllimin e vetëm të kërkimit dhe shpëtimit të mbijetuarve nga një aksident detar. Në raste të tilla operacionet e kërkim-shpëtimit duhet si të jete me praktike të koordinohen nga qendra e veçante e koordinimit të kërkimit-shpëtimit të vendit që ka autorizuar hyrjen ose nga autoritete të ngjashme që janë përcaktuar nga ai vend.
- 3.1.3. Po të mos jete rënë dakord ndryshe ndërmjet vendeve të interesuara, autoritetet e një vendi që duan të përdorin njësitë e tyre të kërkim-shpëtimit në ujërat territoriale, hapësirat detare dhe rajonet e kërkim-shpëtimit të një vendi tjetër me qëllimin e kërkimit të pozicionit të aksidentit detar dhe për shpëtimin e të mbijetuarve të këtij aksidenti, duhet të transmetojnë kërkesën, duke dhënë detajet e plota të misionit dhe nevojën për të realizuar atë të qendrës koordinuese të kërkim-shpëtimit të vendit tjetër ose autoriteteve të ngjashme të përcaktuara për këtë qëllim nga ky vend.
- 3.1.4. Autoritetet kompetente të vendit janë të detyruara:
- 3.1.4.1. të pranojnë menjëherë marrjen e një kërkesë të tillë;
- 3.1.4.2. që menjëherë të njoftojnë kushtet, nëse ka, për ndërmarrjen e një misioni të tillë.
- 3.1.5. Vendet anëtarë të konventës duhet të lidhin marrëveshje me vendet fqinje, në të cilat të parashikohen kushtet për hyrjen e njërive të kërkim-shpëtimit në hapësirat detare, ujërat territoriale të vendeve respektive. Marrëveshje të tilla duhet gjithashtu të sigurojnë futjen e shpejta të këtyre njërive duke kryer formalitete sa më të pakta.

3.1.6. Çdo vend duhet të autorizojë qendrat e tij të koordinimit për kërkim-shpëtimin për sa me poshtë:

3.1.6.1. të kërkojnë nga qendrat e tjera të koordinimit ndihma për anije, avionë, personel ose pajisje sipas nevojës;

3.1.6.2. të garantojë lejen e nevojshme për hyrjen e anijeve, avionëve, personelit dhe pajisjeve në hapësirat detare dhe ujërat territoriale të vendit të tij;

3.1.6.3. të marrë të gjitha masat e nevojshme me autoritetet përkatëse, doganore, policore ose autoritetet e tjera nga pikëpamja e përshpejtimit të veprimit të hyrjes së tyre.

3.1.7. Çdo vend duhet të autorizojë qendrat e tij të koordinimit të sigurojnë, kur kërkohet ndihme qendrave të tjera të koordinimit duke përfshirë ndihmën me anije, avionë, personel dhe mjete të pajisjeve të tjera.

3.1.8. Vendet duhet të hyjnë në marrëveshje për kërkim-shpëtimin me vendet e tyre fqinje në lidhje me kontributin me pajisje, krijimit të procedurave të përbashkëta, kryerjes së stërvitjeve të përbashkëta, kontrolleve të rregullta të kanaleve të komunikimit ndërshtetëror, shkëmbimit të vizitave ndërmjet personelit të qendrave të koordinimit, si dhe shkëmbimit të informacionit.

Koordinimi me shërbimet aeronautike

3.2.1. Vendet janë të detyruara të sigurojnë koordinimin sa më të mirë të mundshëm ndërmjet shërbimit detar dhe aeronautikë në mënyrë të tillë që të sigurohet kërkim-shpëtimi sa më efikas mbi dhe brenda rajoneve të tyre të kërkim-shpëtitimit.

3.2.2. Kur është e realizueshme, vendet krijojnë qendra dhe nenqendra të përbashkëta të koordinimit të kërkim-shpëtitimit për të shërbyer së bashku për qëllime detare dhe aeronautike.

3.2.3. Kur krijohen qendra ose nenqendra të ndara të koordinimit të kërkim-shpëtitimit për detin ose ajrin, në të njëjtën zonë, vendi që ka ato duhet të sigurojë bashkëveprimin dhe koordinimin maksimal ndërmjet këtyre qendrave ose nenqendrave.

3.2.4. Të gjitha vendet duhet të sigurojnë brenda mundësive përdorimin e procedurave të përbashkëta për njësitë e krijuara si për qëllime detare, ashtu dhe për qëllime aeronautike.

KAPITULLI 4 MASAT PËRGATITORE

Kërkesat për informacion

4.1.1. Çdo qendër dhe nenqendër e koordinimit të kërkim-shpëtitimit duhet të kenë informacionin përkatës sa më aktual në lidhje me operacionet e kërkim-shpëtitimit në zonën e tyre duke përfshirë informacionin që ka të bëjë me:

4.1.1.1. njësitë e shpëtitimit dhe njësitë e vrojtimit bregdetar;

4.1.1.2. informacione të tjera në lidhje me shërbime publike ose private, duke përfshirë dhe pajisje të furnizimit me karburant, të cilat janë të dobishme në operacionet e kërkim-shpëtitimit;

4.1.1.3. mjetet e komunikimit që përdoren në operacionet e kërkim-shpëtitimit; 4.1.1.4. emrat, adresat, nr. telefonit dhe fakseve, si dhe telekseve të agjenteve detare, autoriteteve konsullore, organizatave ndërkombëtare e agjencive të tjera, të cilat janë në gjendje për të ndihmuar për të marrë informacione mbi anijet;

4.1.1.5. vendndodhjen, sinjalin e thirrjes së shërbimeve detare të lëvizshme, orët e shërbimit, frekuencat e të gjitha radiostacioneve bregdetare, të cilët mund të përfshihen në operacionet e kërkim-shpëtitimit;

4.1.1.6. vendndodhjen, sinjalin e thirrjes së shërbimeve detare të lëvizshme, orët e vrojtimit dhe frekuencat e të gjithë stacioneve bregdetare të cilët transmetojnë buletine meteorologjike dhe lajmërimi për rajonin e kërkim-shpëtitimit;

4.1.1.7. vendndodhjen, si dhe orët e përgjimit ne radio se bashku me frekuencat e shërbimit te radios;

4.1.1.8. objektet qe mund te ngatërrohen për anije te mbytura te papërcaktuara ose te paraportuara;

4.1.1.9. vendndodhjen e magazinave te furnizimit dhe pajisjeve te përdorshme ne raste emergjence.

4.1.2. Çdo qendër dhe nenqender e koordinimit te kërkim shpëtimit duhet te këtë komunikim te vazhdueshëm ne lidhje me pozicionin, kursin, shpejtësinë dhe sinjalin e thirrjes se anijeve ose stacionit te anijes brenda zonës se tij, te cilat mund te jene ne gjendje te sigurojnë asistencë ndaj anijeve ose personave ne fatkeqësi ne det. Ky informacion mund te ruhet ne qendrën e koordinimit te kërkim-shpëtimit ose duhet te sigurohet lehte kur te jete e nevojshme.

4.1.3. Ne çdo qendër ose nenqender te koordinimit duhet te këtë një harte me shkalle te madhe me qellim te paraqitjes dhe hedhjes se informacionit përkatës ne operacionet e kërkim-shpëtimit ne zonën e tij.

Planet e operimit ose instruksionet

4.2.1. Çdo qendër ose nenqender koordinimi kërkim-shpëtimi duhet te përgatisë ose te këtë ne dispozicion plane dhe instruksione te detajuara për kryerjen e operacioneve te kërkim-shpëtimit ne zonën e tij.

4.2.2. Planet ose instruksionet duhet te specifikojnë masat për shërbimin dhe furnizimin me karburant, me sasinë e plote, për anijet, avionët, si dhe mjetet e tjera te përfshira ne operacionet e kërkim-shpëtimit, duke përfshirë dhe ato te vendeve te tjera.

4.2.3. Planet dhe instruksionet duhet te përmbajnë detaje ne lidhje me veprimet qe do te ndërmerren nga njësitë qe do te përfshihen ne operacionet e kërkim-shpëtimit ne këtë zone duke përfshirë:

4.2.3.1. mënyrën ne te cilën do te kryhen operacionet e kërkim-shpëtimit;

4.2.3.2. përdorimin e pajisjeve dhe sistemeve te komunikimit ne dispozicion;

4.2.3.3. veprimet e përbashkëta qe do te kryhen nga qendrat dhe nenqendrat e tjera te koordinimit te kërkim-shpëtimit sipas rastit;

4.2.3.4. metodën e vënies ne gatishtëri te anijeve ne det dhe avionëve ne fluturim e sipër;

4.2.3.5. detyrat dhe përgjegjësitë e personelit te vendosur për operacione te kërkim-shpëtimit;

4.2.3.6. zhvendosjen e mundshme te pajisjeve qe mund te diktohet nga kushtet

meteorologjike ose kushte te tjera;

4.2.3.7. metodat e marrjes se informacionit thelbësor ne lidhje me operacionet e duhura te kërkim-shpëtimit, si njoftimet për detaret dhe raporte te tjera, buletinet meteorologjike, si dhe gjendja e valëzimit te detit;

4.2.3.8. metodat e marrjes se asistencës se kërkuar nga qendrat ose nenqendrat e koordinimit te kërkim-shpëtimit duke përfshirë anijet, avionët, personelin dhe pajisjet;

4.2.3.9. Metodatat e dhënies se ndihmës nga anijet shpëtuese, ose anije te tjera, për anijet qe ndodhen ne fatkeqësi; dhe

4.2.3.10. metodat e dhënies se ndihmës nga anijet mbiujëse për avionët ne fatkeqësi, te cilët janë raportuar te ulur ne sipërfaqe te ujit.

Gatishmëria e mjeteve te shpëtimit

4.3.1. Çdo njësi e përcaktuar si njësi për kërkim-shpëtimin duhet te jete ne gjendje. gatishmërie ne përputhje me detyrat e saj dhe te informoje për këtë gatishmëri qendrat ose nenqendrat përkatëse te koordinimit te kërkim-shpëtimit.

KAPITULLI 5 PROCEDURAT E OPERIMIT

5.1. Informacioni ne lidhje me emergjencat

5.1.1. Vendet duhet te sigurojnë shërbime te tilla radiopergjimi, te cilat janë praktikisht te nevojshme ne frekuencat ndërkombëtare te fatkeqësisë.

Stacioni bregdetar, i cili merr një sinjal ose thirrje fatkeqësie duhet:

5.1.1.1. te njoftoje menjëherë qendrën ose nenqendren përkatëse te koordinimit për kërkim shpëtimit;

5.1.1.2. te ritransmetoje për aq sa te jete e nevojshme informacion anijeve një ose me shume frekuenca ndërkombëtare te fatkeqësisë ose ne frekuenca te tjera te përshtatshme;

5.1.1.3. t'i paraprijë këtyre transmetimeve me sinjale te posaçme automatike nëse kjo nuk është bere;

5.1.1.4. te ndërmarre veprime te tilla ne vijim siç është vendosur nga autoritetet kompetente.

5.1.2. Autoritetet ose elemente te organizimit te kërkim shpëtimit qe kane arsye te besojnë se një anije është gjendje emergjence, duhet te japin sa me shpejt te jete e mundur te gjithë informacionin qe kane ne dispozicion te qendrave ose nenqendrave te koordinimit te kërkim shpëtimit.

5.1.3. Qendrat dhe nenqendrat e koordinimit te kërkim-shpëtimit me marrjen e informacionit qe ka te beje me një anije ne fatkeqësi, menjëherë duhet te bëjnë vlerësimin e informacionit te marre dhe te përcaktojë fazën e emergjencës ne përputhje me paragrafin 5.2., si dhe ne përputhje me operacionin e kërkuar.

Informacioni ne lidhje me emergjencat

5.2.1. Për qëllime operacionale, do te dallojmë fazat e mëposhtme te emergjencës:

5.2.1.1. **faza e pasigurisë;**

5.2.1.1.1. kur një anije është vonuar me shume se ç' duhet ne destinacion;

5.2.1.1.2. kur një anije nuk arrin ne kohe ne një pozicion te pritur ose kur nuk bën një raportim sigurie;

5.2.1.2. **faza e alarmit;**

5.2.1.2.1. kur ne vijim te fazës se pasigurisë, përpjekjet për te vendosur kontakt me anijen kane dështuar, si dhe kërkesat e bëra për te marre informacion nga burime te tjera te posaçme kane qene te pasuksesshme;

5.2.1.2.2. kur informacioni i marre tregon se një anije ka humbur efikasitetin operacional, por jo ne atë mase qe te ndodhe ndonjë situatë fatkeqësie;

5.2.1.3. **faza e fatkeqësisë;**

5.2.1.3.1. kur merret një informacion i sigurte qe një anije ose person është ne një rrezik te rende dhe te dukshëm dhe ka nevojë për ndihme te menjëhershme;

5.2.1.3.2. kur ne vijim te fazës se alarmit përpjekjet e vazhdueshme për te vendosur kontakt me anijen, si dhe kërkesat e shumta për t'u lidhur me anijen, kane qene te pasuksesshme dhe çojnë ne mendimin se anija mund te jete ne fatkeqësi;

5.2.1.3.3. kur informacioni i marre tregon se efikasiteti operacional i një anije është ne atë mase qe mund te ndodhe një situatë fatkeqësie;

Procedurat për qendrat dhe nenqendrat e koordinimit te kërkim-shpëtimit gjate fazës se emergjencës

5.3.1. Me deklarimin e fazës se pasigurisë, qendra ose nenqendra e koordinimit te kërkim-shpëtimit, sipas rastit duhet te filloje hetimin ne mënyrë qe te përcaktojë fazën ne te cilën ndodhet anija dhe te japë alarmin.

5.3.2. Me deklarimin e fazës se alarmit qendra ose nenqendra e koordinimit te kërkim-shpëtimit, sipas rastit duhet te vazhdoje te kërkohet për anijen e humbur, te vere ne gatishmëri njësitë e saj përkatëse te kërkim-shpëtimit dhe te filloje këto veprime siç përshkruhen ne paragrafin 5.3.3. ne vartësi te rrethanave qe varen nga rasti i krijuar.

5.3.3. Me deklarimin e fazës se fatkeqësisë, qendra ose nenqendra e koordinimit te kërkim-shpëtimit sipas rastit duhet:

5.3.3.1. te filloje veprimet ne përputhje me masat e përcaktuara ne paragrafin 4.2.

5.3.3.2. sipas rastit përcakton shkallen e pasigurisë se pozicionit te anijes dhe te përcaktojë hapësirën e zonës qe do kërkohet;

5.3.3.3. te njoftoje pronarin e anijes ose agjentin e saj nëse është e mundur dhe ta mbaje atë ne korrent te ngjarjeve;

5.3.3.4. te njoftoje qendrat ose nenqendrat e tjera te koordinimit ne lidhje me ndihmën qe mund t'u kërkohet këtyre qendrave ose ne lidhje me angazhimin e këtyre qendrave ose nenqendrave ne operacion;

5.3.3.5. te kërkojë ne fazat e para ndonjë ndihme qe mund te jepet nga avionë, anije ose njësi te tjera qe nuk janë te përfshira ne mënyrë te specifikuar ne organizimin e kërkim-shpëtimit, duke marre ne konsiderate se ne shumicën e situatave emergjente te krijuara ne rajone oqeanike anijet e tjera janë element shume i rëndësishëm për operacionet e kërkim shpëtimit;

5.3.3.6. te hartojte planin e detajuar te kryerjes se operacioneve te nisur nga informacioni qe është marre dhe t'ua komunikojte këtë plan autoriteteve, te përcaktuara ne përputhje me paragrafët 5.7. dhe 5.8. për udhëzim.

5.3.3.7. te përmirësoje sipas nevojës, ne përputhje me rrethanat, udhëzimin qe është përshkruar ne paragrafin 5.3.3.6.;

5.3.3.8. te njoftoje autoritetet përkatëse konsullore ose diplomatike dhe nëse incidenti përfshin persona refugjate ose te shpërngulur, zyrën kompetente te organizmave ndërkombëtare;

5.3.3.9. te njoftoje autoritetet përkatëse te investigimit te aksidenteve detare sipas rastit;

5.3.3.10. te njoftoje çdo avion, anije ose njësi tjetër te përmendur ne paragrafin 5.3.3.5 ne konsultim me autoritetet e përcaktuara ne paragrafët 5.7. dhe 5.8. sipas rastit, kur ndihma e tyre nuk kërkohet me.

5.3.4. Fillimi i operacioneve te kërkim-shpëtimit për një anije te cilës nuk i dihet pozicioni.

5.3.04.1. Ne rastin e deklarimit te një faze emergjence ne lidhje me një anije te cilës nuk i dihet pozicioni, duhet vepruar si me poshtë:

5.3.4.1.1. kur një qendër ose nenqender koordinimi e kërkim-shpëtimit është njoftuar mbi ekzistencën e një faze emergjence dhe nuk ka informacion qe qendra ose nenqendra te tjera po ndërmarrin veprimet e duhura, ajo duhet te marre përgjegjësinë për fillimin e veprimeve përkatëse dhe te komunikojte me qendrat fqinje me objektivin qe një qendër fqinje te pranoje përgjegjësinë menjëherë;

5.304.1.2. po te mos jete vendosur ndryshe ne marrëveshjet ndërmjet qendrave dhe nenqendrave te koordinimit te vendeve te ndryshme qe marrin pjese ne operacione, qendra qe do te përcaktohet do te jete qendra përgjegjëse për zonën ne te cilën anija ndodhej ne pozicionin e fundit te raportuar;

5.3.4.1.3. mbas deklarimit te fazës se fatkeqësisë qendra ose nenqendra e koordinimit qe ka përgjegjësinë e operacionit te kërkimit te shpëtimit duhet nëse është e nevojshme te informoje qendrat e tjera përkatëse për te gjitha rrethanat e gjendjes se emergjencës, si dhe zhvillimet e mëvonshme;

5.3.5. Kalimi i informacionit anijeve për te cilat është deklaruar një faze emergjence.

5.3.5.1. Kurdoherë qe është e aplikueshme, qendrat ose nenqendrat e koordinimit te kërkim-shpëtimit janë përgjegjëse për t'i komunikuar anijes mbi te cilën është deklaruar një faze emergjence informacionin e fillimit te kërkim te shpëtimit te saj.

Koordinimi i operacioneve kur përfshihen 2 ose me shume vende

5.4.1. Kur kryerja e operacioneve mbi te gjithë rajonin e kërkim-shpëtimit është nen përgjegjësinë e me shume se një vendi, çdo vend duhet te ndërmarre masat e duhura ne përputhje me planet operacionale ose instruksionet e referuara ne paragrafin 4.2. kur kërkohet qe te veprohet ne këtë mënyrë nga qendra ose nenqendra e koordinimit te kërkim-shpëtimit te rajonit.

Përfundimi dhe pezullimi i operacioneve të kërkim-shpëtimit

5.5.1. Faza e pasigurisë dhe alarmit.

5.5.1.1. Kur gjate një faze pasigurie ose alarmi një qendër ose nenqender e koordinimit të kërkim-shpëtimit, sipas rastit, njoftohet që emergjenca nuk ekziston me, ajo duhet të njoftojë për këtë çdo autoritet ose njësi shërbimi, e cila ka qene e aktivizuar ose njoftuar.

5.5.2. Faza e fatkeqësisë

5.5.2.1. Kur gjate një faze fatkeqësie, sipas rastit, është njoftuar nga vetë një anije në fatkeqësi, një qendër ose nenqender e koordinimit të kërkim-shpëtimit, se emergjenca nuk ekziston me, atëherë ato duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për ndërprerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe të njoftojë çdo autoritet dhe ose njësi që ka qene e aktivizuar ose e njoftuar.

5.5.2.2. Nëse gjate një faze fatkeqësie është vendosur që kërkimi duhet të ndërpritet, qendra ose nenqendra e koordinimit të kërkim-shpëtimit, sipas rastit duhet të ndalojë operacionet e kërkim-shpëtimit dhe të njoftojë për këtë qellim çdo autoritet dhe njësi kërkim-shpëtimi që ka aktivizuar ose njoftuar. Informacioni që do merret me vone vlerësohet dhe operacionet e kërkim-shpëtimit rifillojnë kur ai është i justifikueshëm mbi bazat e të dhënave të këtij informacioni.

5.5.2.3. Në qofte se gjate një faze fatkeqësie, vendoset që kërkimi i mëtejshëm nuk ka vlere, qendra ose nenqendra e koordinimit të kërkimi-shpëtimit ndërpret operacionet e kërkim-shpëtimit dhe informon çdo autoritet ose njësi shërbimi që ka qene njoftuar ose aktivizuar.

Koordinimi direkt i aktiviteteve të kërkim-shpëtimit

5.6.1. Aktivitetet e njësive të përfshira në operacionet e kërkim-shpëtimit, duke përfshirë njësitë e shpëtimit ose njësitë ndihmuese duhet të koordinohen për të siguruar rezultate sa më efektive.

Përcaktimi i drejtuesit direkt të operacionit dhe përgjegjësitë e tij

5.7.1. Kur njësitë e shpëtimit janë gati të angazhohen në operacionet e kërkim-shpëtimit, njëra nga ato duhet të caktohet si anije e drejtimit direkt sa më afër të jete e mundur dhe mundësisht para mbërritjes në zonat e caktuara të kërkim shpëtimit.

5.7.2. Qendra ose nenqendra përkatëse e koordinimit të shpëtimit duhet të përcaktojë një drejtues direkt. Nëse kjo nuk është mundur praktikisht njësitë e përfshira duhet të përcaktojnë me marrëveshje të përbashkët një drejtues direkt.

5.7.3. Derisa të përcaktohet drejtuesi direkt, njësia e parë e shpëtimit që mbërrin në vendin e ngjarjes, në mënyrë automatike duhet të pranojë detyrat e përgjegjësitë e një drejtimi direkt.

5.7.4. Drejtuesi direkt, sipas rastit, duhet të jete i përgjegjshëm për detyrat në vazhdim kur këto detyra nuk janë kryer nga qendra ose nenqendra e koordinimit të kërkim-shpëtimit, si vijon:

5.7.4.1. përcaktimin e pozicionit të mundshëm të objektit të kërkimi, kufirin e mundshëm të gabimit në këtë pozicion dhe zonën e kërkimit;

5.7.4.2. marrjen e masave për ndarjen e njësive të angazhuara në kërkim, për qëllime sigurie;

5.7.4.3. përcaktimin e formave të përshtatshme të kërkim-shpëtimit për njësitë që marrin pjesë në kërkimin dhe përcaktimin e zonave të kërkim-shpëtimit të njësive dhe grupeve të njësive;

5.7.4.4. përcaktimin e njësive të posaçme për të kryer shpëtimin kur është përcaktuar pozicioni i objektit;

5.7.4.5. koordinimin direkt të komunikimeve për kërkim-shpëtimin.

5.7.5. Drejtuesi direkt është përgjegjës gjithashtu për:

5.7.5.1. dhënien e informacioneve periodike tek qendra ose nenqendra e koordinimit të kërkim shpëtimit;

5.7.5.2. njoftimin e numrit dhe emrave të shpëtuarve tek qendra ose nenqendra, e cila po koordinon operacionet e kërkim-shpëtimit duke i njoftuar qendrës emrin dhe destinacionin e njësisë me të shpëtuarit në bord, duke raportuar se cilët të shpëtuar janë në çdo njësi, si dhe duke kërkuar ndihmë nga qendra si psh. ndihmë mjekësore për të shpëtuarit, të cilët kanë pësuar dëmtime serioze.

Përcaktimi i koordinatorit sipërfaqësor dhe përgjegjësitë e tij

5.8.1. Nëse njësi e shpëtimit (duke përfshirë dhe anijet ushtarake) nuk janë të gatshme të pranojnë detyrat e drejtuesit direkt, por në operacionin e kërkim-shpëtimit janë duke marrë pjesë një numër anijesh tregtare ose mjete të tjera njëra prej tyre duhet të përcaktohet me marrëveshje të përbashkët si koordinatorë e kërkimit të sipërfaqes detare.

5.8.2. Koordinatori i kërkimit sipërfaqësor duhet të caktohet praktikisht sa më parë të jete e mundur dhe mundësisht përpara mbërritjes në zonën e veçante të kërkimit.

5.8.3. Koordinatori i kërkimit sipërfaqësor duhet të jete përgjegjës për të gjitha detyrat e përmendura në paragrafët 5.7.4 dhe 5.7.5. në vartësi të mundësive të anijes.

Veprimet e fillimit

5.9.1. Çdo njësi me marrjen e informacionit të një incidenti fatkeqësie do të ndërmarre çfarëdo veprimi të menjëhershëm për të ndihmuar brenda mundësive të saj ose do të japë alarmin anijeve të tjera, të cilat mund të jene në gjendje të ndihmojnë dhe do të njoftojnë qendrën apo nenqendren e koordinimit të shpëtimit në zonën e se cilës ka ndodhur incidenti. Zonat e kërkimit

5.10.1. Zonat e kërkimit të përcaktuara në përputhje me paragrafin 5.3.3.2, 5.7.4.1 ose 5.8.3, mund të ndryshohen sipas vlerësimit të komandantit direkt ose të koordinatorit të kërkimit sipërfaqësor, i cili duhet të njoftojë qendrën ose nenqendren e koordinimit të shpëtimit për veprimet e tij dhe arsyet e të vepruarit në këtë mënyrë.

Format e kërkimit

5.11.1. Format e kërkimit të përcaktuara në përputhje me paragrafin 5.3.3.6, 5.7.4.3 ose 5.8.3 mund të ndërrohen ose ndryshohen në formë të tjera, nëse konsiderohet e nevojshme nga drejtuesi direkt ose koordinatori i kërkimit sipërfaqësor, i cili duhet të njoftojë qendrën e koordinimit të kërkim-shpëtimit ose nenqendren e koordinimit të kërkim-shpëtimit për veprimet e tij dhe arsyet e të vepruarit në këtë mënyrë.

Kërkim i suksesshëm

5.12.1 Kur kërkimi ka qene i suksesshëm, drejtuesi direkt ose koordinatori i kërkimit sipërfaqësor duhet të drejtojë njësitë që janë me të pajisura me pajisje shpëtimi për të kryer shpëtimin ose të sigurojë ndihmë tjetër të nevojshme.

5.12.2 Kur është e mundur njësitë që kryejnë kërkim-shpëtimin duhet të njoftojnë drejtuesin direkt ose koordinatorin e kërkimit sipërfaqësor mbi numrin dhe emrat e të shpëtuarve që kanë në bord, nëse i gjithë personeli është i mjaftueshëm për kryerjen e operacionit të kërkim-shpëtimit ose kërkohet asistencë suplementare, për evakuimin njerëzor dhe destinacionin e njerëzve.

5.12.3 Drejtuesi direkt ose koordinatori i kërkimit sipërfaqësor menjëherë duhet të njoftojë qendrën apo nenqendren e koordinimit të shpëtimit kur kërkimi ka qene i suksesshëm.

Kërkimi i pasuksesshëm

5.13.1. Kërkimi duhet të ndërpritet vetëm atëherë kur nuk ka më shprese për shpëtimin e të mbijetuarve .

5.13.2. Qendra apo nenqendra e koordinimit të shpëtimit, e cila po bën koordinimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit, normalisht duhet të jete përgjegjëse për përfundimin e kërkim-shpëtimit.

5.13.3. Në zonat e largëta oqeanike, të cilat nuk janë në përgjegjësinë e ndonjë qendre të koordinimit të kërkim-shpëtimit ose kur qendra përgjegjëse nuk është në pozicion të përshtatshëm për koordinimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit, drejtuesi direkt ose

koordinatori i kërkimit sipërfaqësor mund të marrë përgjegjësinë për përfundimin e kërkim-shpëtimit.

KAPITULLI 6 SISTEMET E RAPORTIMEVE TE ANIJEVE

Te përgjithshme

6.1.1. Vendet duhet të krijojnë një sistem raportimi të anijeve për zbatim brenda çdo rajoni të kërkim-shpëtimit për të cilat ato janë përgjegjëse, kur kjo konsiderohet e nevojshme për të lehtësuar operacionet e kërkim-shpëtimit dhe mendohet se është e praktikueshme.

6.1.2. Vendet që do të krijojnë një sistem të raportimit të anijeve duhet të marrin në konsideratë rekomandimet e organizatës.

6.1.3. Sistemi i raportimeve të anijeve duhet të bllokojë informacionin e vazhdueshëm mbi lëvizjet e anijeve sipas radhës në rastin e një incidenti dhe fatkeqësie.

6.1.3.1. Te reduktoje intervalin e kohës ndërmjet humbjes së kontaktit me një anije dhe fillimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit në rastet kur nuk merret ndonjë sinjal fatkeqësie.

6.1.3.2. Te lejoje përcaktimin e shpejte të anijeve, të cilat mund të thirren për të siguruar asistencë.

6.1.3.3. Te lejoje planëzimin e një zone kërkimi të një madhësie të kufizuar në rastin e një anije në fatkeqësi pozicioni i së cilës është i panjohur apo i pacaktuar.

6.1.3.3. Te lehtësojë parashikimin e ndihmës urgjente mjekësore për anijet që nuk kanë doktor në bord.

Kërkesat operacionale

6.2.1. Për arritjen e objektivave të vendosura në paragrafin 6.1.2. sistemi i raportimit të anijeve duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme operacionale.

6.2.1.1. Parashikimin e operacionit duke përfshirë planet e lundrimit dhe raportimin e pozicioneve, të cilat do të mundësojnë në përcaktimin e pozicioneve të ardhshme të anijeve pjesëmarrëse.

6.2.1.2. Mbajtjen e një plansheti të pozicionit të anijeve,

6.2.1.3. Marrjen e raportimeve me materiale të përshtatshme nga anijet pjesëmarrëse

6.2.1.4. Thjeshtësia në përcaktimin e sistemit dhe të operacionit, dhe

6.2.1.5. Përdorimi i një forme standard të pranuar në marrëveshje ndërkombëtare, dhe të procedurave të miratuara me marrëveshje ndërkombëtare.

Llojet e raportimit

6.3.1. Një sistem raportimi i anijeve duhet të përfshijë raportimet e mëposhtme:

6.3.1.1. Plani i lundrimit - duke dhënë emrin, shenjen e thirrjes ose shenjen e identifikimit të stacionit të anijes, datën dhe orën (sipas G.M.T.) e nisjes, detajet e pikës së nisjes së anijes, portin e mbërritjes, kursin e parashikuar, shpejtësinë, datën dhe Kohën e mbërritjes (sipas G.M.T), si dhe ndryshimet që duhet të raportohen sa më parë të jete e mundur

6.3.1.2. Raportimi i pozicionit - duke dhënë emrin, sinjalin e thirrjes ose shenjen e identifikimit të stacionit të anijes, datën dhe Kohën (sipas G.M.T), pozicionin, kursin dhe shpejtësinë.

6.3.1.3. Raportimi final - duke dhënë emrin sinjalin e thirrjes ose shenjen e identifikimit të stacionit të anijes, datën dhe Kohën (sipas G.M.T) të mbërritjes në destinacion ose të largimit nga zona e mbuluar prej sistemit.

Përdorimi i sistemeve.

6.4.1. Vendet duhet të nxisin të gjitha anijet të raportojnë pozicionet e tyre kur udhëtojnë në zonat për të cilat janë bërë marrëveshje për të grumbulluar informacion mbi pozicionet e anijeve për qëllime të kërkim shpëtimit.

6.4.2. Vendet qe regjistrojnë informacione mbi pozicionin e anijeve duhet qe te shpërndajnë këtë informacion, për aq sa te jete e mundur praktikisht tek shtetet e tjera kur kërkohet nga këto shtete për qëllime te kërkim-shpëtimit.